



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RAPORT MONITORUES PËR KEDS DHE KESCO

**INVESTIMET KAPITALE-SHPENZIMET OPERATIVE DHE PËRFORMANCA E TË
LICENCUARVE PËR PERIUDHËN 2013-2015**

Dhjetor 2016



Përmbajtja:

1. HYRJE.....	4
1.1 Përmbledhje ekzekutive.....	4
1.2 Sektori i rregulluar - metodologjia.....	6
2. Monitorimi i investimeve kapitale dhe shpenzimeve operative të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.....	7
2.1 Investimet kapitale	7
2.1.1 Investimet e ndërlidhura me ngarkesën	7
2.1.2 Investimet jo të ndërlidhura me ngarkesën.....	8
2.1.3 Investimet tjera-jo operative	8
2.2 Realizmi i investimeve kapitale	9
2.3 Ndikimi i investimeve kapitale në parametrat e performancës.....	11
2.4 Humbjet në sistemin e shpërndarjes.....	13
2.5 Shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes.....	15
3. Monitorimi i investimeve kapitale dhe operative për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike.....	17
3.1 Realizmi i investimeve kapitale	17
3.2 Shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes.....	18
3.3 Blerjet e energjisë elektrike të Furnizuesit Publik	19
3.4 Faturimi dhe Inkasimi	21



Shkurtesat:

BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
CAPEX	Capital Expenditures (Shpenzimet kapitale)
FP	Furnizuesi Publik
GWh	Gigavatorë
HC	Hidrocentral
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut
kV	Kilovolt
kW	Kilovat
LP	Largpërçues
MAR	Të Hyrat Maksimale të Lejuara (HML)
MW	Megavat
MWh	Megavatorë
NS	Nënstacioni
OPEX	Operational Expenditures (Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes)
OSSH	Operator i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operator i Sistemit të Transmisionit
OT	Operator Tregu
RoR	Rate of Return (Norma e kthimit)
RAB	Regulated Asset Base (Baza e Rregulluar e Aseteve)
SCADA	Supervisory Control and Data Acquisition (Sistemi Mbikëqyrës dhe i Mbledhjes së të Dhënave)
Sh.A	Shoqëri aksionare
TC	Termocentral
TL	Tensioni i lartë
TR	Transformator
TM	Tensioni i Mesëm
TU	Tensioni i Ulët
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji



1. HYRJE

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), në pajtim me kompetencat dhe obligimet e përkufizuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe në Rregullën për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë ka ndërmarr monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara energjetike në Kosovë për periudhën raportuese 2013-2015. Në harmoni me këto ligje ZRRE ka themeluar grupe punuese për monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të tilla. Një ndër këto grupe është edhe grupi punues për monitorim e investimeve kapitale, shpenzimeve operative dhe indikatorëve të tjerë të performances të të licencuarve KEK, KOSTT, KEDS dhe KESCO.

Stafi i ZRRE-së, gjatë muajit shtator 2016 ka mbajtur takime me menaxhmentin e KEK-ut, KEDS/KESCO dhe të KOSTT-it lidhur me investimet kapitale të implementuara në sektorin e energjisë, shpenzimet operative të realizuara si dhe performancën e ndërmarrjeve në sektor. Me qëllim të shmangies së paqartësive eventuale të të dhënave dhe të gjeturave të prezantuara në këtë raport, ZRRE paraprakisht e ka dërguar në KEDS dhe KESCO draftin fillestar për komentim.

1.1 Përmbledhje ekzekutive

Raporti përmban informata dhe të dhëna të raportuara nga të licencuarit për periudhën 2013-2015, konstatime që dalin nga procesi i monitorimit në sferën e investimeve kapitale, shpenzimeve operative dhe indikatorët tjerë të performances. Pas të gjitha analizave, grupi punues i këtij raporti, ka paraqitur të gjeturat kryesore rreth investimeve kapitale dhe shpenzimeve operative të KEDS dhe KESCO. Ky raport do të shqyrtohet në detaje gjatë shqyrtimit periodik të rregullt tarifor.

Të gjeturat kryesore për shqyrtim nga Bordi i ZRRE-së për KEDS, janë si në vijim:

- Mos përmbushja e parametrave të përcaktuara nga ZRRE që ka të bëjë me nivelin e humbjeve për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes është si rezultat i vonësive në implementimin e projekteve kapitale dhe mos realizimin e mirëmbajtjes sipas nivelit të lejuar nga ZRRE.
- Meqenëse, mos realizimi i investimeve kapitale për vitet 2013 dhe 2014 nuk është realizuar në vitet në vijim, OSSh nuk ka arritur të kompenzojë mos realizimin e investimeve të mbetura në vitet e cekuara më lartë.



- Përkundër nevojës së madhe për riparime dhe mirëmbajtje të rrjetit të shpërndarjes për shkak të gjendjes ekzistuese të tij, KEDS nuk ka realizuar nivelin e duhur të operimit dhe mirëmbajtjes. Si rezultat i nivelit të ultë të realizimit të këtyre shpenzimeve nuk është arritur përmirësimi i shërbimit të furnizimit me energji elektrike në nivelin e kërkuar.

Të gjeturat kryesore për shqyrtim nga Bordi i ZRRE-së për KESCO, janë si në vijim:

- Ndër aktivitetet kryesore të realizuara nga Furnizuesi Publik gjatë kësaj periudhe është përmbushja e obligimit ligjor që del nga pakoja e tretë e ligjeve e që ka të bëjë me ç'thurjen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Ky proces është kryer në pajtueshmëri me Udhëzuesin për Shturje ligjore të KEDS/Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nga Furnizuesi Publik sipas vendimit të ZRRE-së V_619_2014.
- Furnizuesi Publik në këtë periudhë ka rritur arkëtimin nga 88% duke filluar në vitin 2013 në 95% në fund të vitit 2015, ky trend i përmirësimit është duke vazhduar edhe në vitin 2016, por në këtë raport nuk mund të bëhet ndonjë krahasim qenësor deri në përfundimin e vitit 2016. ZRRE pret që norma e inkasimit të jetë e krahasueshme me vendet e rajonit dhe Evropës.
- Në blerjet e energjisë ndër parametrat kryesor që ka pasur një përmirësim për tërë sistemin dhe respektivisht që ka ndikuar në çmime me të ulta të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët fundor është çmimi i importit të energjisë elektrike. Në vitin 2013 çmimi i importit të realizuar ishte 62.1€/MWh ndërsa në fund të vitit 2015, çmimi i importit u realizua në vlerë prej 51.8€/MWh.
- ZRRE vëren se Furnizuesi Publik ka bërë një përmirësim të performancës për periudhën 2013-2015 krahasuar me vitet paraprake, dhe inkurajohet të vazhdojë përmirësimin edhe në vitet në vijim.



1.2 Sektori i rregulluar - metodologjia

Ne sektorët e rregulluar, te hyrat e lejuara maksimale përcaktohen nga rregullatori ashtu që të licencuarit ti mbulojnë kostot e tyre të arsyeshme për ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Ngarkesat (çmimet) dizajnohen ashtu që të mbulojnë kostot për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Ne kuadër të të hyrave të lejuara janë edhe kostot që kanë të bëjnë me investimet kapitale. Metodologjia në bazë të cilës njihen kostot e të licencuarve përmbajnë elemente të performancës ashtu që secili operator nxitet të bëjë investimet e duhura duke i mundur kthim të arsyeshëm për investimet e bëra.



Figura 1-RoR (Kthimi i rregulluar)

Norma e kthimit (WACC) aprovohet nga rregullatori dhe aplikohet më pastaj ndaj vlerës së investimeve kapitale (CAPEX-it) për të kalkuluar kthimin e lejuar.

Duke qenë ky sektorë të rregulluar, rregullatori i energjisë siguron që interesat e kompanisë dhe konsumatorëve të jenë të balancuara. Norma e kthimit për investime aprovohet nga rregullatori për periudhë rregullative (4-5 vite) dhe ajo garanton që operatori të sigurojë fitim të rregulluar të arsyeshëm dhe konsumatorët të përfitojnë në kualitetin e shërbimit.

Me poshtë është paraqitur figurativisht nxitja e investimeve përmes normës së kthimit dhe balancimi i interesave ndërmjet kompanisë dhe konsumatorëve nëpërmjet rregullimit.



Figura 2-Rregullimi



2. Monitorimi i investimeve kapitale dhe shpenzimeve operative të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Në këtë seksion përshkruhet ndikimi i investimeve kapitale në sigurinë e operimit, cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve dhe efikasitetin në operim për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2013- 2015.

Për realizimin e investimeve kapitale i licencuari që operon me rrjetin e shpërndarjes duhet t'i dorëzojë Zyrës së Rregullatorit për Energji listën e projekteve dhe arsyeshmerinë për lejimin e projekteve të tilla. Kjo listë e projekteve përfshihet në planin zhvillimor të operatorit dhe duhet të ofrojë të dhëna teknike dhe financiare për secilin projekt të veçantë.

Sfera e investimeve të rrjetit të shpërndarjes është fokusuar në çështjet kryesore të cilat janë të identifikuar në rrjetin e shpërndarjes siç janë; transformatorët e mbingarkuar, problemet me tensionin e ulët, humbjet në rrjet, etj.

2.1 Investimet kapitale

Me qëllim të caktimit të prioriteteve për realizimin e investimeve kapitale, operatori i sistemit të shpërndarjes bënë planifikimin e investimeve varësisht nga shtytësit e investimeve. Duke pasur parasysh këta shtytës, investimet kapitale mund të grupohen në:

- Investime të ndërlidhura me ngarkesën (load related)
- Investimet që nuk janë të ndërlidhura me ngarkesën (non-load related)
- Investimet tjera-jo operative

2.1.1 Investimet e ndërlidhura me ngarkesën

Investimet kapitale të ndërlidhura me ngarkesën shkaktohen kryesisht për asetet e reja për të përmbushur ngarkesën e rritur në rrjet, e cila shkaktohet nga kyçjet e reja apo nga rritja e konsumit të energjisë nga konsumatorët ekzistues. Qëllimi i këtyre investimeve është që të garantohet furnizim i qëndrueshëm dhe stabil për konsumatorët fundor. Këto investimet përfshijnë:

- Ndërtimi i nënstacioneve të reja
- Përforcimi-sigurimi i kapacitetit shtesë në nën-stacionet 35/10 kV
- Eliminimi i “fyteve të ngushta” në linja, kablllo dhe transformatorëve të mbingarkuar në 35 kV, 10 kV dhe TU.



- Rritja e kapacitetit të këtyre “fyteve të ngushta” apo anashkalimi i tyre me qarqe të reja lejon shfrytëzimin e kapacitetit të plotë të aseteve ekzistuese.

2.1.2 Investimet jo të ndërlidhura me ngarkesën

Investimet kapitale jo të ndërlidhura me ngarkesë synim në rend të parë kanë zëvendësimin e aseteve të vjetruara. Këto investime nuk shkaktohen nga konsumatorët e riinjë, por nevoja për të bërë investime ka të bëjë me riparime dhe mirëmbajtje të aseteve ekzistuese. Këto investimet përfshijnë:

- Përforcimin vjetor të rrjetit (zëvendësim i linjave dhe transformatorëve)
- Zëvendësimi i linjave që janë me rrezik për sigurinë publike

2.1.3 Investimet tjera-jo operative

Investimet kapitale jo-operative kanë të bëjnë me ndikimin e drejtë për drejtë në operimin e operatorit. Këto investimet përfshijnë:

- Përmirësimin vjetor të pikës matëse
- Implementimi i Sistemit të Menaxhimit të Distribucionit (SMD) dhe automatizimit të nënstacioneve në nivel 35kV
- Qendra Dispeqerike, TIK (Teknologjia Informative e Komunikimit) etj



2.2 Realizimi i investimeve kapitale

Me qëllim të përmirësimit të kualiteti të shërbimit dhe furnizimit me energji elektrike KEDS gjatë periudhës 2013 – 2015 ka realizuar një numër të konsiderueshëm të projekteve kapitale të cilat arrijnë vlerën rreth 55 mil€ apo 86% krahasuar me nivelin e lejuar nga ZRRE prej 64 mil€. Realizimi i investimeve kapitale në raport me lejimet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.




Figura 3-CAPEX 2013-2015 KEDS

Realizimi i projekteve kapitale është paraqitur në tabelën në vijim:



Emrat e projekteve	2013		2014		2015	
	Lejuar (€'000)	Aktual (€'000)	Lejuar (€'000)	Aktual (€'000)	Lejuar (€'000)	Aktual (€'000)
Projektet e Bartura	5,423	5,778	-	5,909	-	547
Ndërtimi Qendrës Dispeçerike të OSSH-së	300		-		-	
Ndërtimi i NS të ri 35kV NS Junik	500		-		-	
Ndërtimi i NS të ri 35kV NS Besi	100		-		-	
Ndërtimi i NS të ri 35kV NS Mushtisht	60		-		-	
Përforcimi Vjetor i Rrjetit - Zëvendësimi i linjave 10kV dhe 0.4kV, shtyllave dhe transformatorëve 10/0.4kV të selek	4,404	2,871	4,404	797	4,404	5,640
Shtimi i transformatorëve 8 MVA, 35/10(20)kV 35/10(20)kV në NS Mazgiti dhe NS Lladova	360		-		-	
Zgjerimi i NS-ve 35kV ekzistuese NS Ferizaji I, NS Magura, NS Zhuri dhe NS Xërxa	800		530	290	530	117
Shtimi i transformatorëve 8 MVA, 35/10(20)kV 35/10(20)kV në NS Ferizaji III dhe NS Prizreni III	-		240		-	
Furnizim me kthina të Tensionit të Mesëm 35kV dhe 10(20)kV në NS 110kV dhe 35kV	500		500		500	55
Eleminimi i linjave distributive ajrore me rrezikshmëri për publikun	1,305		3,757	1,153	4,264	650
Eleminimi i fyteve të ngushta në linjat distributive - Linjat e mbingarkuara 35kV dhe 10kV	1,124		3,005	311	2,919	813
Eleminimi i fyteve të ngushta në Nënstationet 10/0.4kV - Nënstationet 10/0.4kV të mbingarkuara	882	1,227	1,750	1,166	1,452	576
Eleminimi i fyteve të ngushta në linjat distributive - Linjat e mbingarkuara 0.4kV	988		1,647	1,647	2,134	672
Shtimi i transformatorëve 8 MVA, 35/10(20)kV 35/10(20)kV në NS Kllokot dhe NS Rrafshina/Vitia	-		-		240	59
Transformatorë Distributiv 10(20)/0.4kV	400		400	400	400	1,433
Shtimi i transformatorëve 8 MVA, 35/10(20)kV 35/10(20)kV në NS Pirana dhe NS Peja II	-		-		-	117
Shtimi i transformatorëve 8 MVA, 35/10(20)kV 35/10(20)kV në NS Gjakova II dhe NS Shtërpca	-		-		-	
Implementimi i SCADA DMS në TM të NS 110kV dhe automatizimi i plotë i NS 35kV	1,300		1,300		1,300	
Përmirësimi Vjetor i Pikës matëse të konsumatorët shtëpiak dhe Llogaritje të Energjisë	3,000	3,913	3,000	5,820	3,000	7,727
Blerja dhe instalimi i sistemit për testim dhe kalibrimin të njuhësorëve	200		-		-	140
Automjet për testim dhe detektim të linjave nëntoksore	-		250		-	
Automjet për mirëmbajtje të transformatorëve 35kV dhe 10/0.4kV - Filtrim I vajit të transformatorit	-		200		-	
Makineri për mirëmbajtje të rrjetit Distributiv (Gjilan, Gjakovë dhe Pejë)	-		250	288	250	1,397
Software License Purchase		107				
Vehicle Tracking System		105		200		
Vehicles/cars		1,679				
Various LV projects		290				
Master Development Plan		600				73
Software për monitorimin e punëve dhe përmirësimin e kualitetit të Energjisë						572
Gjithsejtë	21,646	16,570	21,233	17,981	21,393	20,588

Tabela 1-CAPEX i lejuar dhe realizuar KEDS

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme disa nga projektet lejohen dhe realizohen për një vitë të caktuar, por disa për shkak të natyrës së projektit lejohen dhe realizohen në progres.

Projektet kapitale për vitin 2016 në këtë faze nuk mund të raportohen ngase ato janë në proces të implementimit. Nga informatat e pranuar nga KEDS vlera e investimeve kapitale të kontraktuara për vitin 2016 është 21mil€.

Projektet e realizuara nga KEDS sipas distrikteve janë paraqitur në tabelën në vijim:

Distriktet	2014	2015
Prishtina	30	34
Peja	27	64
Mitrovica	13	24
Prizreni	20	29
Gjakova	11	30
Ferizaj	10	24
Gjilani	2	13
Total	113	218

Tabela 2-Projektet sipas distrikteve

Të dhënat kuantitative për projektet e KEDS-it janë paraqitur në tabelën në vijim:

		Kontraktori		KEDS		TOTAL	
Lloji i punës	Njësia	2014	2015	2014	2015	2014	2015
Nën-stacion i ri 10(20)/0.4 kV	cp	13	90	7	32	20	122
Ndërrim I trafove të mbingarkuara	cp	1	-	101	160	102	160
Shtylla	cp	9,405	8,338	1,693	4,736	11,098	13,074
Kablo ajrore	m	15,384	534,156	24,169	96,068	39,553	630,224
Kablo nëntokësore	m	36,177	92,456	14,395	38,472	50,572	130,928

Tabela 3-Të dhënat kuantitative sipas projekteve

2.3 Ndikimi i investimeve kapitale në parametrat e përfomancës

Pas privatizimit me 8 maj 2013, plani i investimeve për vitin 2013 u ripunua nga KEDS, për të mbajtur nivelin e investimeve të aprovuara nga ZRRE-ja për vitin 2013. Duke marr parasysh se operimi si KEDS ka filluar me 8 maj 2013 atëherë për këtë vit ndikimi i investimeve kapitale nuk mund të vlerësohet por ndikimi i këtyre investimeve është në vitet në vijim, megjithatë në këtë raport për vitin 2013 është paraqitur lista e projekteve të realizuara.



Projekti	€000
Projektet e Bartura	5,778
Përforcimi Vjetor i Rrjetit - Zëvendësimi i linjave 10kV dhe 0.4kV, shtyllave dhe transformatorëve 10/0.4kV të selektuar në të gjitha 7 Distriktet	2,871
Eliminimi i fyteve të ngushta në linjat distributive - Linjat e mbingarkuara 0.4kV	1,227
Përmirësimi Vjetor i Pikës matëse te konsumatorët shtëpiak dhe Llogaritje të Energjisë	3,913
Blerja e licensave për softuer	107
Sistemi për monitorimin e veturave	105
Veturat	1,679
Projekte të ndryshme në TU	290
Master Plani zhvillimor	600
Total	16,570

Tabela 4-CAPEX i realizuar në vitin 2013

Nga projektet kapitale të realizuara gjatë vitit 2014 vlera e reduktuar e humbjeve në tërësi është 56,277 MWh, respektivisht për projektet e realizuara ka një reduktim të humbjeve për 22.7%, apo ndikimi në reduktimin e humbjeve totale është për 0.7%. Përderisa gjatë vitit 2015 vlera e reduktuar e humbjeve në tërësi është 20,041 MWh, respektivisht për projektet e realizuara ka një reduktim të humbjeve për 7.9%, apo ndikimi në reduktimin e humbjeve totale është për 0.43%.

Projekti	Reduktimi i humbjeve (kWh)	Ndikimi i projektit në humbje (%)	Ndikimi në total humbjet (%)	Ndikimi në Euro (€)	Ndërprerjet (h)	Zvogëlimi i ndërprerjeve (%)
Përforcimi Vjetor i Rrjetit Zëvendësimi i linjave 10kV dhe 0.4kV, shtyllave dhe transformatorëve 10/0.4kV të selektuar në të gjitha 7 Distriktet	2,736,862	7.30	0.06	156,001		
Projekti zhvendosja e njehsorve	49,005,716	11.65	0.53	2,793,326		
Eliminimi i linjave distributive ajrore me rrezikshmëri për publikun					823	4.85
Përforcimi i linjave të rrjetit distributiv të mbingarkuar 35kV & 10kV	2,582,000	1.62	0.06	147,174	372	2.20
Përforcimi i nënstacioneve të mbingarkuar 10/0.4kV	1,953,248	2.10	0.04	111,335		
Total	56,277,826		0.7	3,207,836	1,195	7.05

Tabela 5-Ndikimi i investimeve kapitale per vitin 2014



Projekti	Reduktimi i humbjeve (kWh)	Ndikimi i projektit në humbje (%)	Ndikimi në total humbjet (%)	Ndikimi në Euro (€)	Ndërprerjet (h)	Zvogëlimi i ndërprerjeve (%)
Përforcimi Vjetor i Rrjetit Zëvendësimi i linjave 10kV dhe 0.4kV, shtyllave dhe transformatorëve 10/0.4kV të selektuar në të gjitha 7 Distriktet	10,857,547	14.50	0.23	714.75		
Përforcimi i linjave të rrjetit distributiv të mbingarkuar 35kV & 10kV	974,312	8.60	0.03	64.14	880	10
Përforcimi i nënstacioneve të mbingarkuar 10/0.4kV	1,444,517	0.33	0.02	75.34		
Përforcimi i transformatorëve distributiv të mbingarkuar 10/0.4kV dhe rrjetit 0.4 kV	7,064,740	9.32	0.15	465.07		
Total	20,041,116	7.9	0.43	1,319.31	880	10

Tabela 6-Ndikimi i investimeve kapitale për vitin 2015

2.4 Humbjet në sistemin e shpërndarjes

Në një sistem energjetik energjia elektrike nga prodhimi deri tek konsumatori dërgohet nëpërmjet rrjetit të transmisionit dhe rrjetit të shpërndarjes. Duke qenë se për shkak proceseve fizike jo e gjithë energjia e prodhuar arrihet të dërgohet deri tek konsumatori fundor për shkak të humbjeve, gjeneratori duhet të prodhojë energji shtesë për ti mbuluar këto humbje.




Figura 4-Humbjet në sistem

Këto humbje mund të blihen direkt nga operatori i rrjetit përkatës qoftë bartje (transmision) apo shpërndarjes (distribucionit) apo nga furnizuesi në emër të këtyre operatorëve. Megjithatë konsumatorët ngarkohen vetëm me nivelin e arsyeshëm të humbjeve.

Përkundër nivelit të realizuar të investimeve kapitale prej 86% për periudhën 2013- 2015, humbjet në sistemin e shpërndarjes vazhdojnë të jenë akoma më të larta se niveli i lejuar nga ZRRE.



Caqet e përcaktuara nga ZRRE për zvogëlimin e humbjeve në OSSh janë vendosur ashtu që për tre vitet e para të periudhës rregullative duhet të reduktohen humbjet prej 3% për çdo vit dhe 2.5% në vitet vijuese të periudhës rregullative. Reduktimi i humbjeve është në pikë përqindje dhe përfshinë cakun për reduktimin e humbjeve teknike dhe komerciale.

Sidoqoftë, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nga viti 2013 deri në vitin 2015 ka reduktuar humbjet në nivelin prej 4.5% pikë përqindje, ndërsa caku i përcaktuar nga ZRRE që duhet të arrihej për këtë periudhë ishte 8.5% (3% për vitin 2013, 3% për vitin 2014 dhe 2.5% për vitin 2015). Në mos realizimin e këtyre humbjeve një pjesë e tyre është e trashëguar nga mbajtësi paraprak i licencës për OSSh (KEK) në vlerë prej 1.8%.

Në metodologjinë e cila aplikohet për të caktuar të Hyrat e Lejuara Maksimale, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka nxitje që në rast të arritjes së caktut të humbjeve mbi nivelin e lejuar të mbaj përfitimin dhe në rastin të mos arritjes ai ndëshkohet.

Në figurën në vijim është paraqitur trendi i reduktimit të humbjeve për vitet 2013-2015.




Figura 5-Humbjet e lejuara dhe realizuara nga OSSh 2013-2015



2.5 Shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes

Ndikim në uljen e humbjeve në OSSh përveç investimeve kapitale kanë edhe shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes. Mirëmbajtja dhe riparimet e rregullta gjithashtu kanë ndikim në operimin më kualitativ të sistemit. Zyra e Rregullatorit për Energji me qëllim që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të funksionojë në mënyrë të sigurt dhe të ofrojë kualitet të shërbimit për konsumatorë ka lejuar koston prej 18.3 mil€ për periudhën 2013-2015.

Përshkrimi	Lejuar 2013	Realizuar 2013	Lejuar 2014	Realizuar 2014	Lejuar 2015	Realizuar 2015	Total Lejuar	Total Realizuar	Përqindja
	€000	€000	€000	€000	€000	€000	(€000)	(€000)	%
Riparimi dhe Mirëmbajtja	5,577	2,831	6,490	3,739	6,217	3,319	18,284	9,887	54%

Tabela 7-Kostot e riparimeve dhe të mirëmbajtjes

Nga tabela e mësipërme shihet se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka realizuar për periudhën 2013- 2015 vetëm 9,9 mil€ apo 54%. Një nivel kaq i ultë i realizimit të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes gjithsesi se ka ndikimin edhe në arritjen e parametrave të përcaktuar nga rregullatori.

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve operative të lejuara dhe të realizuara 2013-2015 është paraqitur në vijim:

Përshkrimi	Njesia	Lejuar 2013	Realizuar 2013	Lejuar 2014	Realizuar 2014	Lejuar 2015	Realizuar 2015	Total lejuar 2013-2015	Total realizuar 2013-2015	Realizimi %
Kostot e Personelit	€'000	7,638	6,341	8,557	9,138	16,604	18,110	32,798	33,589	102%
Derivate	€'000	697	277	812	402	773	789	2,282	1,468	64%
Mirëmbajtje	€'000	5,577	2,829	6,490	3,739	6,217	3,319	18,284	9,887	54%
Të tjera	€'000	2,408	951	2,773	2,230	2,614	4,462	7,795	7,643	98%
Total	€'000	16,319	10,398	18,631	15,509	26,208	26,680	61,158	52,587	86%

Tabela 8- Kostot e operimeve dhe të mirëmbajtjes

Siç shihet nga tabela e mësipërme për periudhën 2013-2015 niveli total i realizuar i OPEX-it ndaj nivelit të lejuar nga ZRRE është 86%.

Në vitin 2015 për shkak të shturjes ndërmjet Shpërndarjes dhe Furnizimit, kostot e OSSh-së janë rritur e po ashtu kostot e Furnizuesit janë zvogëluar për të njëjtën vlerë, sepse janë bartur disa funksione nga OSSh në Furnizim.

Shturja e KEDS-it në dy kompani, në KEDS dhe KESCO, natyrisht se do të ndikojë në aspektin e kostove që asociohen me këto kompani. Bartja e funksioneve nga një kompani në kompaninë tjetër duhet të asociohet edhe me shtim, përkatësisht zvogëlim të kostove për kompaninë



përkatëse. Me qëllim të eliminimit të rrezikut për rritjen e kostove për të dy entitetet ligjërisht të ndara, e që do të rezultonte në dyfishimin e funksioneve dhe respektivisht çmime me të larta për konsumatorët fundor, ZRRE me vendimin V_619_2014 ka udhëzuar që shërbimet e përbashkëta (si: IT, financa, çështjet legjislative, etj) të kryhen nga OSSh, bazuar në një marrëveshje në mes të OSSh-se dhe Furnizuesit Publik. Ka disa përfitime nga zbatimi i konceptit të shërbimeve të përbashkëta, së pari koncepti mbështet zbatimin e legjislacionit evropian për paketën e dytë dhe të tretë të ndarjes së proceseve, se dyti siguron përfitime mbi centralizimin e proceseve dhe në këtë mënyrë sjell përfitime si p.sh mundësitë për të standardizuar dhe automatizuar proceset, përdorimin e përbashkët të infrastrukturës duke ndarë kështu kostot e tyre. Një përfitim tjetër është ndarja e infrastrukturës së SI dhe IT të cilat janë shumë të kushtueshme nëse zbatohen veçmas secila.



3. Monitorimi i investimeve kapitale dhe operative për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike

Nga 1 janari i vitit 2015 Furnizuesi Publik është ç'thurur nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, dhe me këtë rast disa kosto që kanë qenë pjesë e Furnizuesit Publik janë bartur tek OSSh. Nga ky proces i ç'thurjes disa nga funksionet si: leximi, kyçjet, çkyqjet të cilat kanë qenë funksione të Furnizuesit kanë kaluar si funksione të OSSh-së. Në këtë kuptim edhe disa nga kostot e operimit dhe të mirëmbajtës për Furnizuesin Publik nga viti 2015 janë dukshëm me të ulta se në vitet paraprake.

3.1 Realizmi i investimeve kapitale

Projektet kapitale të Furnizuesit Publik kanë të bëjnë kryesisht me pajisjet e teknologjisë informative. Investimet kapitale për Furnizuesin Publik janë lejuar në vlerë prej 0.4 mil€ për vit për gjatë tërë periudhës rregullative. Një lejim i tillë është me arsyetimin e përditësimit të pajisjeve të IT-së dhe automjeteve të nevojshme për operim të furnizuesit, ngase automjetet ekzistuese të cilat janë bartur gjatë procesit të privatizimit kanë qenë të vjetruara dhe si të tilla kanë pasur kosto të lartë të mirëmbajtjes dhe shpenzime të mëdha të derivateve.

Në tabelën në vijim janë paraqitur investimet kapitale të lejuara dhe të realizuar për vitet 2013-2015.

Emrat e projekteve	2013		2014		2015	
	Lejuar (€'000)	Aktual (€'000)	Lejuar (€'000)	Aktual (€'000)	Lejuar (€'000)	Aktual (€'000)
Instrumente dhe Vegla	395	395	395	395	395	114
Gjithsejtë	395	395	395	395	395	114

Tabela 9-CAPEX i lejuar dhe realizuar për Furnizuesin Publik

Nga tabela shihet se Furnizuesi Publik për vitet 2013-2015 ka realizuar 0.9 mil€ investime kapitale apo 76% ndaj vlerës se lejuar nga ZRRE për këto vite.




Figura 6- Lejimi dhe realizimi i CAPEX-it

Detajizimi i projekteve kapitale të lejuara për Furnizuesin Publik është dhënë në tabelën në vijim:

Linjat e CAPEX-it	Lejuar €
Furnizimi me kompjuter	50,000
Furnizimi me printer për departamentin e faturimit	35,000
Printer për arka	40,000
Aparate te fotokopjes	20,000
Automjete	250,000
Total	395,000

Tabela 10-CAPEX-i sipas linjave për Furnizuesin Publik

3.2 Shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes

Në vijim është bërë krahasimi i shpenzimeve operative (OPEX) të lejuara dhe realizuara nga Furnizuesi Publik. Fokusi është bërë në linjat kryesore të këtyre shpenzimeve operative, siç janë: shpenzimet e personelit, mirëmbajtjes, derivateve, shpenzimet e sigurimit fizik të objekteve dhe shpenzime të tjera.

Nga viti 2015 e tutje shpenzimet operative për Furnizuesin Publik janë dukshëm më të ulta se në vitet paraprake. Kjo rezulton siq u cek edhe me lartë si pasojë e ç'thurjes ligjore dhe funksionale të KEDS-it, me ç'rast disa funksione nga Furnizuesi Publik me Energji Elektrike (KESCO) kanë kaluar në kompaninë KEDS. Si rezultat i këtij procesi, rreth 800 të punësuar janë transferuar nga Furnizuesi Publik (KESCO) në OSSH (KEDS), dhe gjithashtu kostot që asociohen me këta punëtorë. Nga ky procesi në janar të vitit 2015 është licencuar kompania e re për Furnizim me Energji Elektrike-KESCO.



Në pajtim me udhëzimet e ZRRE-se procesi i ç'thurjes është bërë ashtu që disa departamente si: IT, Prokura, Financa, Burimet njerëzore, etj të mbesin si shërbime të përbashkëta për të dy kompanitë me qëllim që të mos ketë dyfishim të kostove.

Përshkrimi	Njesia	Lejuar 2013	Realizuar 2013	Lejuar 2014	Realizuar 2014	Lejuar 2015	Realizuar 2015	Total lejuar 2013-2015	Total realizuar 2013-2015	Realizimi %
Kostot e Personelit	€'000	8,531	6,341	9,479	10,440	1,311	1,723	19,320	18,504	96%
Derivate	€'000	590	277	683	459	826	-	2,099	736	35%
Mirëmbajtje	€'000	791	2,829	908	2	1,093	59	2,792	2,890	104%
Të tjera	€'000	2,510	951	2,869	1,978	3,443	2,578	8,823	5,507	62%
Total	€'000	12,423	10,398	13,939	12,879	6,673	4,360	33,034	27,637	84%

Tabela 11- Kostot e operimeve dhe të mirëmbajtjes KESCO

Nga tabela e mësipërme shihet se Furnizuesi Publik për periudhën 2013-2015 ka realizuar shpenzimet operative në vlerë prej 27.6 mil€ apo 84% ndaj nivelit të lejuar.

3.3 Blerjet e energjisë elektrike të Furnizuesit Publik

ZRRE lejon mjete të mjaftushme për blerjen e energjisë elektrike për Furnizuesin Publik në baza vjetore (sipas parimit ex-ante), mirëpo për dallimet që ndodhin në mes të vlerës së lejuar dhe asaj të realizuar, ZRRE në pajtim me rregullat e çmimeve bënë përshtatjet e duhura. Blerjet e energjisë së importuar janë të bazuara në cmimet e tregjeve ndërkombtare, dhe si të tilla janë të përfshira në tarifat e konsumatoreve të rregulluar.

Me qëllim të furnizimit me energji elektrike Furnizuesi Publik blen energji si nga tregu vendor po ashtu edhe ai i jashtëm. Blerjet nga gjenerimi vendor kanë të bëjnë me blerjet nga prodhuesi publik KEK dhe nga disa gjeneratorë tjerë të kyqur në nivel të transmisionit siç është HC Ujmani dhe nga gjeneratorë tjerë të kyqur në nivel të shpërndarjes siç janë: HC Dikanc, HC Lumardh, HC Burimi, HC Radavc, dhe centrale tjera që prodhojnë energji nga burimet e ripërtrishme. Përveç blerje të energjisë elektrike, Furnizuesi Publik eksporton energji elektrike me qëllim të balancimit të rrjedhave të energjisë në sistem.

Në figurën në vijim janë paraqitur blerjet e energjisë për periudhën 2013-2015. Siç shihet nga figura, në vitin 2014 kemi një ulje të prodhimit dhe një ngritje të importit të energjisë, kjo për faktin se në qershor të vitit 2014 kishte ndodhur aksidenti në TC A dhe si rezultat kemi ulje të prodhimit. Gjithashtu vërehet se kemi një rënie në sasi të import të energjisë në vitin 2015, ngase kjo energji ka filluar pjesërisht të zëvendësohet nga gjenerimi vendor.




Figura 7-Blerjet e energjisë MWh

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur çmimi mesatar i të gjitha blerjeve, çmimi mesatar i importit dhe eksportit.




Figura 8-Çmimet e blerjeve të energjisë

Duhet theksuar se në këtë raport blerjet e energjisë janë paraqitur si të realizuara në terma real dhe si të tilla ato nuk përfshijnë dallimet ndërmjet vlerave të lejuara ndaj atyre të realizuara.

Në figurë mund të shihet se çmimi mesatar i blerjeve totale të energjisë është përafërsisht i njëjtë në këtë periudhë (29.9€/MWh), ndërsa kemi një ulje të çmimit të importit.



3.4 Faturimi dhe Inkasimi

Energjia e cila faturohet tek konsumatorët fundor nuk arrin që e tëra të inkasohet nga furnizuesi, ky fenomen është i pranishëm edhe në kompanitë më të zhvilluara në botë.

Furnizuesi Publik gjatë periudhës 2013-2015 ka pasur një trend pozitiv në faturim dhe inkasim. Ky përmirësim është i lidhur edhe me investimet në paisjet e dorës për leximin dhe faturimin e konsumatoreve të quajtur “HHU”, e cila mundeson lexim dhe faturim më efikas.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur konsumi i klasifikuar sipas grupeve tarifore në MWh.

Kategoria e konsumatorëve	2013	2014	2015	Total
	MWh	MWh	MWh	MWh
Industrial	726,544	852,587	934,592	2,513,723
Komercial	696,643	696,929	740,318	2,133,890
Shtëpiak	2,114,792	1,999,835	2,068,761	6,183,388
Ndriçimi publik	17,963	18,512	19,377	55,852
Total	3,555,942	3,567,863	3,763,047	10,886,853

Tabela 12-Konsumi i energjise 2013-2015

Nga figura e mëposhtme shihet se struktura e konsumit dominohet prej 56.8% nga konsumatorët shtëpiak.




Figura 9-Struktura e konsumit

Gjatë viteve të fundit energjia e faturuar ka pasur rritje të vazhdueshme, por edhe arkëtimi është në rritje dhe tashmë është rreth 95% dhe mund të konsiderohet si nivel ndërkombtarisht i pranueshëm.




Figura 10-Arkëtimi dhe faturimi